



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale për Arsim

05.Nr.754 /2019

Me.08.10.2019

Duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale e në harmoni me Rregullorës 03/2019 për Ndarjen e Bursave për studentët e Komunës së Istogut Drejtori i Drejtoratit për Arsim në Istog shpall këtë:

K o n k u r s

I. Për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2019/2020

- Bursat ndahen për vitin akademik 2019/2020 për shkollimin universitar themelor.
- Numri i Bursave të planifikuara 35 (tridhjetë e pesë)
- Bursat akordohen me kohëzgjatje prej nje 1 (një) viti akademik më të drejtë vazhdimi, nëse përfituesi i bursës e ka regjistruar më sukses vitin pasues.
- Lartësia e bursës është 50 euro (pësdhjetë euro) për muaj respektivisht në shumën e përgjithshme prej 600 euro (gjashqind euro) për vitin akademik të studimeve.

II. Kriteret për ndarjen e bursave

Kandidatët vlerësohen sipas kriterëve si me poshtë:

- Studentët e familjeve të cilët nuk kanë asnjë anëtar nga familja e ngushtë të punësuar dhe nuk krijojnë të ardhura nga asnjë vëprimtari,deshmohet me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës,kjo kategori vlerësohen me 10 pikë;
- Studentët të cilët nga familja e ngushtë kanë një anëtar me nevoja të veçanta vlerësohen me 5 pikë;
- Studenti i vetëm nga familja e ngushtë vlerësohet me 5 pikë,dy student vlersohën me 10 pikë, tre e me shumë vlersohën me 15 pikë.
- Studentët nga familja në asistencë sociale vlersohën me 10 pikë.
- Studentet me nevoja të veçanta vlersohën me 15 pikë.
- Studentet nga familja e ngusht e deshmorit,vlersohen me 15 pikë.
- Studentet nga familja e ngusht e invalidit të luftës,nga familja e ngusht e veteranit të luftes ,studentet e viktimave civile të luftes vlersohën me 10 pikë.
- Studentet pa të dy prindërit vlersohen me 15 pikë ndërsa ata me njërin prind vlersohen me 10 pikë.
- Studentet të cilët vijnë nga drejtimet deficitare të përcaktuara me nenin 4 të kësaj Rregullorje vlersohen me 10 pikë.

Në rast së studentët grumbullojnë pikë të njëjta,përparësi i jepet kandidatëve femra e në rast së kandidatët janë të gjinisë së njëjtë përparësi i jepet kandidatit që studion lëmin deficitare.

Përfitues të bursës janë ata kandidat që arrijnë të bëjnë pikë më shumë duke u renditur në listë.

III. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i kësaj burse nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë apo i punësuar.

IV. Dokumentet e nevojshme për aplikim për Bursa (Kushtet për Aplikim)
Për realizimin e të drejtës në bursë kandidatët (aplikuesit) duhet t'i plotësojnë kushtet si me poshtë.

- Dokument i identifikimit (kopja e letërnjoftimit);
- Certifikatën e vendbanimit;
- Certifikata apo (Vërtetimi) që deshmon së është student i rregullt dhe të mos ketë humbur vitin shkollorë gjatë studimeve.
- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin vijus të studimeve 2019/2020;
- Certifikatën e bashkësisë familjare.
- Studentët e vitit të parë sjellin kopjet e diplomës dhe dëftesat nga shkolla e mesme të vërtetuara;
- Si dhe vërtetimet për secilën kategori të parapara me pikën 2 të këtij konkursi.

V. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e regjistruar në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës të cilët notën mesatare gjatë studimeve e kane 7.5 e me lartë ,ndërsa nxënësit të cilët kanë regjistruar vitin e parë të studimeve nota mesatare nga shkolla e mesme duhet të jetë mbi 4.5 e me lartë.

VI. Kohëzgjatja e konkursit:

-Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit përkatësisht, në gazetë ditore ,ne ueb faqen zyrtare të komunës dhe në tabelën e shpalljeve ;

-Aplikacioni mund të tërhiqet në Qendrën për Shërbim me Qytetar ,zyra nr.100 kati përdhes i njeiti pas plotësimit dorëzohet po në të njëjtën zyre.

-Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;



Drejtori DKA-së
Hajrush Shoshi